



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 8213 Prot.

Tiranë, më 19 . 11 . 2020

U D H Ë Z I M

Nr. 12 , Datë 19 . 11 . 2020

PËR

**“TRAJTIMIN ANTI-COVID AMBULATOR NË BANESË TË PERSONAVE TË
TESTUAR POZITIV ME SARS COV 2 NGA MJEKU I FAMILJES”**

Në zbatim të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 307, datë 21.05.2014, “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga siguri i detyrueshëm shëndetësor”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 908, datë 18.11.2020, “Për miratimin e paketës së trajtimit Anti-Covid ambulator në banesë, që do të financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”,

U D H Ë Z O J:

1. Pacientët e konfirmuar si pozitiv me Sars Cov-2 do klasifikohen në kategorinë e dedikuar për këtë qëllim në Sistemin e Kartës së Shëndetit. Mjeku i familjes bën regjistrimin e kategorisë dhe plotësimin e afatit përkatës.
2. Gjatë përshkrimit të recetës me rimbursim, Mjeku i Familjes pasi të ketë zgjedhur kategorinë Sars Cov-2, sipas gjendjes së pacientit për zgjedh diagnozën Infeksion CoVID 19 me kod ICD9 1009 për raste e lehta dhe 1010 për rastet e moderuara.
3. Për barnat që janë pjesë e Listës së Barnave së Rimbursuara si:

Azithromycine 250 mg,

Acid Acetylsalicylic 100 mg,

Rivaroxaban 15 mg,

Apixaban 5 mg,

Dexamethasone 0.5 mg

Ibuprofen 400 mg

do të përshkruhen në recetën me rimbursim nga mjekët e kontraktuar, sipas emrit xhenerik, sipas formë-dozës dhe duke zbatuar kufizimet përkatëse të vendosura, sipas urdhërit të Fondit, në përdorim, sasi dhe kohëzgjatje.

4. Për barnat që nuk janë pjesë e Listës së Barnave të Rimbursuara, por që janë pjesë e skemave të mjekimit të pacientëve të testuar pozitiv me Sars-Cov-2 si:

Nr.	Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Çmimi/njësi	Emri Tregëtar	MBAJTESIA AUTORIZIMI PËR TREGTIM
1	Levofloxacin	500 mg	f. c. tabl.	91.8	LEVALOX	KRKA, d.d., NOVO MESTO -SLOVENI/Trimed
2	Paracetamol	500 mg	tablet	2.8	Paracetamol	PROFARMA SH.A - SHOIPERI

Suplementet si më poshtë:

Nr.	Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Çmimi/njësi	Emri Tregëtar	DEPO
1	Vitamine C	1000 mg	tableta efërveshente	26.6	Vitamin C 1000 mg effervescent tab	FarmaNet
2	Vitamine C	1000 mg	pluhur i tretshëm	26.6	C FAST	CFO
3	Vitamine C	1000 mg	tablet/capsul	26.6	Pulliera 30 Natura House	Free farma
4	Vitamine C	1000 mg	tablet/capsul	26.6	Medi C	MediPharma Company
5	Vitamine C	1000 mg	tablet/capsul	26.6	C-1000 RH CR	ELBA SHPK
6	Vitamine D	2000 UI	tablet/capsul	24.4	D-VIT 3 2000 UI classics	FarmaNet
7	Vitamine D	2001 UI	Softgels	24.4	High Potency Vitamin D-3 2000 IU	ELBA SHPK

do të përshkruhen në recetën me rimbursim nga mjekët e kontraktuar, sipas emrit xhenerik, sipas formë-dozës dhe duke zbatuar urdhërin nr. 579, datë 14.10.2020 “Për miratimin e udhëzuesit mbi ndjekjen në shtëpi të rasteve me infeksion Covid – 19” të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Kohëzgjatja maksimale e trajtimit do të jetë jo më shumë se 1 Muaj dhe nuk do të kalojë vlerën e rimbursimit (sipas Skemës) të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave.
- Në zbatimin të udhëzuesit të miratuar me urdhërin nr. 579, datë 14.10.2020, “Për miratimin e udhëzuesit mbi ndjekjen në shtëpi të rasteve me infeksion Covid – 19” të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është mjeku i familjes që përcakton skemën e mjekimit që duhet të trajtohet pacienti i testuar pozitiv me Sars-Cov-2, në varësi të gjendjes dhe sëmundjeve bashkëshoqëruese.
- Kosto e rimbursimit të paketës për skemën e lehtë të trajtimit nuk do të jetë më shumë se 1,650 (njëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë.
Kosto e rimbursimit të paketës për skemën e modeuar të trajtimit nuk do të jetë më shumë se 10,900 (dhjetëmijë e nenteqind) lekë.
- Receta më pas do të ekzekutohet në farmacitë e rrjetit të hapur me kontratë me Fondin.
- Farmacia pas hyrjes në sistem, do të identifikojë pacientin duke vendosur NID të pacientit, dhe më pas plotëson kodin identifikues të recetës, dh në sistem i shfaqet receta elektronike sipas përshkrimit të mjekut.
- Farmacia dakortëson me pacientin elementët e recetës për barnat e LBR-së, për barnat jashtë LBR do të jepen sipas formatit të pikës 4 më lart.
- Farmacia ekzekuton recetën elektronike në përputhje me terapinë e rekomanduar nga mjeku i familjes.
- Procesi i pranimit të dosjes së rimbursimit të subjektit farmaceutik për barnat dhe suplementet jashtë LBR-së, do të bëhet me kopjet e faturave origjinale nga depot të vulosura (ku bari ose suplementi të shënohet me shenjën x, si dhe të shënohet numri i recetës elektronike).
- Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si dhe Drejtoritë Rajonale të Fondit për zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elisa Bërziu



Nr. 02/13/ Prot.
11Tiranë, më 14.12. 2020

UDHËZIM

Nr. 14, Datë 14.12. 2020

PËR

“PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 12, DATË 19.11.2020 ‘PËR TRAJTIMIN ANTI-COVID AMBULATOR NË BANESË TË PERSONAVE TË TESTUAR POZITIV ME SARS COV 2 NGA MJEKU I FAMILJES’”

Në zbatim të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 307, datë 21.05.2014, “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 908, datë 18.11.2020, “Për miratimin e paketës së trajtimit Anti-Covid ambulator në banesë, që do të financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”,

UDHËZOJ:

1. Në Udhëzimin nr. 12, datë 19.11.2020 “Për trajtimin anti-covid ambulator në banesë të personave të testuar pozitiv me sars cov 2 nga mjeku i familjes” të riformulohet pika 4 si më poshtë:

Për barnat që nuk janë pjesë e Listës së Barnave të Rimbursuara, por që janë pjesë e skemave të mjekimit të pacientëve të testuar pozitiv me Sars-Cov-2 si:

Nr.	Principi Aktiv	Formëdoza	Njësia	Çmimi/njësi (lek)
1.	Levofloxacin	500 mg	f.c. tabletë	91.8
2.	Paracetamol	500 mg	tabletë	2.8

Suplementet si më poshtë:

Nr.	Principi Aktiv	Formëdoza	Njësia	Çmimi/njësi (lek)
1.	Vitaminë C	1000 mg	tabletë efervescente / pluhur i tretshëm tabletë / capsul	26.6

2.	Vitaminë D	2000 UI	tabletë capsul softgels	24.4
----	------------	---------	-------------------------------	------

do të përshkruhen në recetën me rimbursim nga mjekët e kontraktuar, sipas emrit xhenerik, sipas formë-dozës dhe duke zbatuar urdhërin nr. 579, datë 14.10.2020 “Për miratimin e udhëzuesit mbi ndjekjen në shtëpi të rasteve me infeksion Covid – 19” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si dhe Drejtoritë Rajonale të Fondit për zbatimin e këtij Udhëzimi.
3. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

(i komanduar)

Albana Cela

